



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr. 1/9 Prot

Vlorë, më 07 . 04 . 2021.

VENDIM
Nr.2, datë 31.03.2021

PËR

“MIRATIMIN E KËRKESËS PËR PEZULLIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR TË PËRROIT TË MEZHGORANIT, PËR PRODHIM ENERGJIE ELEKTRIKE, ME VENDNDODHJE, NJËSIA ADMINISTRATIVE MEZHGORAN, BASHKIA TEPELENË, QARKU GJIROKASTËR”



Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së subjektit “Invictus” sh.p.k për pezullimin e lejes Nr.serie 5 me Nr. 13 Prot., datë 13.04.2018 miratuar me vendim Nr.2 datë 05.04.2018, leje për përdorim të burimit ujor të përroit të Mezhgoranit, për prodhim hidroenergjie, me vendndodhje, njësia administrative Mezhgoran, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë.

2. Parametrat teknik paraprak për këtë fazë janë si më poshtë:

HEC Bregu i Lerës :

Vepra e marrjes - X=4423371 - Y=4465581 - Z=615-m.m.n.d

Godina e Centralit - X=4424493 - Y=4463521 - Z=160 m.m.n.d

Qmes=0.415m³/s

Qllog=0.552m³/s

Qeko=0.038m³/s

Fuqia e instaluar N=1995 kw

Energjia Vjetore E=6336254 kw/vit

3. Pezullimi i lejes bëhet për një periudhë 2-vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI
FLAMUR MAMAJ

Flamur Mamaj